



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 541 Akti

Nr. 583 Vendimi
Tiranë, më 3.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------------|-----------|
| Valbona Sanxhaktari | Kryesuese |
| Genta Tafa (Bungo) | Relatore |
| Lulzim Hamitaj | Anëtar |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 1.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ols Dado, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, i komanduar në cilësinë e ndihmës magjistratit.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Ols Dado, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, i komanduar në cilësinë e ndihmës magjistratit, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Ols Dado do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Valbona Sanxhaktari dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Valbona Sanxhaktari, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ols Dado.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Ols Dado nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ols Dado. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ols Dado.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 18.10.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tri kriteret për subjektin e rivlerësimit Ols Dado, si dhe njoftimin e subjektit

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.02.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 26.10.2017, përditësuar dhe deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. ***, datë 15.6.2022.

për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 19.10.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 20.10.2022, ndërsa në datën 21.10.2022 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë me *e-mail* në datën 27.10.2022.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 1.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

19. Subjekti i rivlerësimit Ols Dado mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Ols Dado ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës dhe pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 27.10.2022.

⁵ "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: 'Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit'. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1. Subjekti ka filluar detyrën në datën 17.11.2008 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

23.2. Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Apartament⁶ 2+1, me sipërfaqe 115.89 m², Njësia Bashkiake Nr. *, blv. “Zogu I”, rr. “M.M”, p. **, hyrja *, k. *. Kontrata e sipërmarrjes nr. *. Shuma totale e paguar për blerjen: 74.110 euro, e likuiduar tërësisht para fillimit të detyrës. Pjesa takuese: 100%.**

lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) aktmarrëveshje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.1.2004; (ii) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.12.2011 dhe vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 23.12.2011; (iii) lajmërim debitimi pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë; (iv) mandatarkëtim nr. *** datë 30.9.2004 dhe nr. *** datë 10.12.2004; (v) mandatdepozitim nga Ols Dado pranë “Raiffeisen Bank”; (vi) vendim datë 24.2.1998, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; (vii) fletë njoftim tatimi, lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Durrës për tatimpaguesin G.B; (viii) urdhërpagesë datë 3.2.2004 në BKT për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në shumën 20.000 lekë dhe mandatdepozitim datë 3.2.2004 në BKT, të shumës 179.530 lekë, nga G.B; (ix) tabela e llogaritjes së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin “G.B” me NIPT K***F, për vitin 2005; (x) licencë nga Bashkia Durrës për aktivitetin e regjistruar në emër të G.B; (xi) mandatdepozitim datë 28.1.2005 të shumës 39.100 lekë, nga G.B; (xii) tabela e llogaritjes së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin “G.B”, me NIPT K***F, për vitin 2003; (xiii) urdhërpagesë nga tatimpaguesi G.B dhe urdhërpagesë në BKT, datë 3.2.2004, nga G.B; (xiv) kthim përgjigje nr.*** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e

Burimi sipas deklaratës Vetting: (i) jetesa bashkëshortore, vitet 1999 – 2005, depozituar 33.310 euro, viti 2004, kryesisht aktiviteti privat i ish-bashkëshortes; (ii) depozituar nga babai shuma 34.800 euro, viti 2004, aktiviteti privat i prindërve, pension i plotë pleqërie, shitje pasurish të paluajtshme; (iii) dy depozita, secila 3.000 euro, viti 2006, nga deklaruesi, aktiviteti privat 2005 – 2008, pagat 1995 – 2005, shitje ¼ pjesë e pandarë në apartament banimi; (iv) bashkëjetesa me prindërit deri në vitin 2008.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

25. Subjekti, në datën 21.1.2004, ka lidhur aktmarrëveshjen nr. ***, për blerje të një apartamenti me sip. 129.8 m², me çmim 600 euro/m² nga shoqëria “K” sh.p.k. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje rezultojnë se subjekti ka likuiduar kështu e parë 26.000 euro, ndërsa diferencën 51.880 euro do ta shlyente gjatë periudhës së ndërtimit dhe dorëzimit të apartamentit.

26. Në datën 23.12.2011 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, ku çmimi në kontratë është përcaktuar 75.000 euro, i cili është likuiduar totalisht nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale. Në këtë kontratë sipërfaqja e brendshme është përcaktuar 115.89 m², ndërsa ambientet e përbashkëta 9.11 m², në total 125 m². Apartamenti rezultojnë i regjistruar me nr. pasurie ***, z. k. ***, Tiranë.

27. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm konstatohet mospërputhje në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, pasi sipas deklarimit të subjektit është 74.110 euro, sipas aktmarrëveshjes është 77.880 euro, ndërsa në kontratën e shitblerjes është 75.000 euro. Në lidhje me këtë konstatim subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës Vetting një përkthim mbi pasuritë e krijuara, burimet e krijimit të tyre dhe shumat e të ardhurave në momentin e krijimit, ku ka deklaruar se shuma 77.880 euro është vendosur për shkak të përlllogaritjes së metrave të banesës, e cila në kontratën e sipërmarrjes ka qenë 129.8 m² me çmim 600 euro/m². Në përfundim, sipërfaqja ka rezultuar 115.89 m².

Tatimeve Durrës; (xv) vendim nr. ***, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për emërim të z. M. D si noter në këtë gjykatë; (xvi) vërtetim datë 30.6.1992, nga Kolektivi i Avokatëve Durrës për ushtrimin e aktivitetit “avokat” nga M.D, prej datës 1.10.1991; (xvii) vendim datë 31.8.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për regjistrimin e M.D si person fizik për të ushtruar veprimtarinë e tij noter; (xviii) kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës; (xix) deklaratë, nënshkruar nga Ols Dado në datën 1.3.2007; (xx) vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Bashkia Durrës; (xxi) certifikatë regjistrimi në organin tatimor; (xxii) vërtetim nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga ISSH; (xxiii) vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, lëshuar nga ISSH për znj. R.D; (xxiv) vërtetim nr. extra prot., datë 18.10.2016, nga Bashkia Durrës; (xxv) vërtetim nr. ** prot., datë 30.5.2008, nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shansëve të Barabarta; (xxvi) vërtetim datë 3.2.2005, nga Bashkia Durrës; (xxvii) vërtetim datë 5.6.2008, nga “A.M.C” sh.a.; (xxviii) vërtetim nr. *** prot., datë 2.6.2008, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; (xxix) vërtetim nr. *** prot., datë 16.8.2005, nga Komisioni i Letrave me Vlerë; (xxx) librezë pune e Ols. M. Dado; (xxxi) kontratë shitblerjeje datë 25.11.1991; (xxxii) kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.3.2005; (xxxiii) kontratë shitblerjeje nr. *** rep. nr. *** kol. datë 30.1.2004.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.12.2020, e Drejtorisë Vendore Tirana Veri; shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.10.2020, e DRT-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.10.2020, e QKB-së; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-*** prot., datë 6.10.2020, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar Furnizuesit të Shërbimit Universal; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2022, drejtuar DRT-së Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.7.2022, e DRT-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2022, drejtuar noterit publik Sh.C; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.6.2022, e noterit Sh. C.

28. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2008, subjekti ka deklaruar: *“Apartament 2+1, me sipërfaqe 129.8 m². Çmimi 600 euro/m², likuiduar 74.110 euro, i palikuiduar 3.770 euro. 34.800 euro derdhur nga prindërit, marrëdhënie pune nga 1995. Aktiviteti privat nga 2005. Shitje pjesë apartamenti 1/4”*.

29. Në lidhje me shumën 3.770 euro të deklaruar si detyrim në DPV/2008, subjekti ka sqaruar se është deklaruar duke iu referuar kontratës së sipërmarrjes. Në momentin e hartimit të kontratës së blerjes dhe matjes reale të apartamentit, rezultoi se vlera e tij është më e vogël nga ajo e deklaruar, si rrjedhim detyrimi ndaj firmës shuhej, duke qenë se ishte kryer pagesa e plotë.

30. Subjekti, në procesverbalin⁸ e datës 13.1.2016 pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar se *kjo diferencë ka ardhur si rezultat i ndryshimit të sipërfaqes së apartamentit në matjen reale dhe si derivat i përlllogaritjes në vlerë, gjithsesi vlera e apartamentit në kontratën e blerjes është më e vogël se ajo e deklaruar nga ana e tij*.

Komisioni konstaton se subjekti ka qartësuar dhe ka qenë konsistent përgjatë gjithë periudhës së deklarimit, për rrjedhojë nuk lindin dyshime në lidhje me çmimin e paguar dhe të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

31. Subjekti, për të provuar pagesën e çmimit të këtij apartamenti, ka depozituar dokumentacionin si vijon:

- a. Lajmërim debitimi pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë për transferimin e shumës 10.600 USD në datën 19.1.2004, nga llogaria e Ols dhe R.D në favor të llogarisë “K.A” sh.p.k., me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”.
- b. Lajmërim debitimi pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë për transferimin e shumës 22.354 USD në datën 19.1.2004, nga llogaria e Ols dhe R.D në favor të llogarisë “K. A” sh.p.k., me përshkrimin “këst për blerje apartamenti”.

Në lidhje me këto dy depozitime, nga hetimi i llogarisë së përbashkët të subjektit dhe nënës së tij në USD në “Intesa Sanpaolo Bank”, rezulton se subjekti në datën 19.1.2004 ka depozituar shumën 22.354 USD, të cilën e ka transferuar në po të njëjtën datë në llogarinë e “K.A” sh.p.k.

- c. Mandatarkëtim nr. ***, datë 30.9.2004, i shoqërisë “K.A” sh.p.k., të shumës 34.800 euro, paguar nga babai i subjektit për apartamentin e prenotuar, me shënim “kësti i II-të”.
- d. Mandatarkëtim nr. ***, datë 10.12.2004, i shoqërisë “K.A” sh.p.k., të shumës 7.310 euro, paguar nga subjekti nëpërmjet llogarisë në Bankën Amerikane të Shqipërisë.

Bashkëlidhur ndodhet mandati i Bankës Amerikane të Shqipërisë, në të cilën subjekti ka depozituar në datën 10.12.2004 shumën 7.310 euro në llogarinë bankare të “K.A” sh.p.k., me përshkrim “këst apartamenti”.

- e. Mandatdepozitim datë 1.6.2006, nga subjekti pranë “Raiffeisen Bank”, të shumës 3.000 euro, në favor të llogarisë “K.A” sh.p.k.
- f. Mandatdepozitim datë 11.6.2007, nga subjekti pranë “Raiffeisen Bank”, të shumës 3.000 euro, në favor të llogarisë “K.A”, me përshkrimin “derdhje këst apartamenti”.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka paguar shumat 48.110 euro dhe 32.950 USD (26.000 euro), në total 74.110 euro.

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.9.2020, të ILDKPKI-së.

Në lidhje me burimin e të ardhurave

32. Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* edhe një përskrim mbi pasuritë e krijuara, burimet e krijimit të tyre dhe shumat e të ardhurave në momentin e krijimit, ku ka deklaruar si vijon:

- i. 26.000 euro + 7.310 euro = 33.310 euro kanë si burim aktivitetin e bashkëshortes së tij. Periudha e martesës ka qenë nga viti 1999 deri në vitin 2005. Të ardhurat e dokumentuara për periudhën 2000 – 2004 janë 11.337.000 lekë;
- ii. 34.800 euro kanë si burim të ardhurat e prindërve. Babai i tij ka depozituar në favorin e tij shumën në datën 30.9.2004;
- iii. 3.000 + 3.000 euro në vitin 2006 kanë si burim aktivitetin privat si noter, punësimi në vite, si dhe të ardhurat e krijuar nga prindërit, pasi ka jetuar me ta.

33. Në lidhje me burimin e parë të deklaruar: *“Nga jetesa bashkëshortore 1999 – 2005. Depozituar 33.310 euro, viti 2004. Kryesisht aktiviteti privat i ish-bashkëshortes”*

Për të provuar të ardhurat e ligjshme të ish-bashkëshortes së tij, subjekti ka depozituar:

- vendimin nr. ***, datë 24.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për regjistrimin e shtetas G.B si person fizik në ushtrimin e aktivitetit “noter”;
- fletënjoftimin e tatimit për periudhën 1998 – 2002, lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Durrës;
- dokumentacionin provues për pagimin e detyrimeve tatimore për periudhën 2003 – 2005;
- certifikatën nga Bashkia Durrës për aktivitetin e regjistruar në emër të znj. G.B;
- shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti “G.B”.

Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se QKB-ja dhe DRT-ja Durrës konfirmojnë të njëjtat të dhëna, të cilat janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën *Vetting*.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm janë llogaritur të ardhurat e ish-bashkëshortes së subjektit për periudhën 1998 – 2005, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

Të ardhurat e ish-bashkëshortes së subjektit G.B për periudhën 1999 – 2005

Tabela nr. 1

| Të ardhurat e ish-bashkëshortes së subjektit G.B | Periudha 1999 – 2005 |
|---|-----------------------------|
| Të ardhura nga paga sipas ISSH-së | 661,863.34 |
| Të ardhura nga aktiviteti privat NOTERI | 5,643,129.60 |
| Total | 6,304,992.94 |

Marzhi i fitimit për të ardhurat e ish-bashkëshortes së subjektit si notere është konsideruar në masën 40%, duke iu referuar marzhit të fitimit të viteve pasardhëse të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

34. Për të provuar të ardhurat e ligjshme të tij, subjekti ka depozituar:

- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës mbi të ardhurat e realizuara;
- vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Bashkia Durrës për subjektin “Ols Dado” me aktivitet noter, me NIPT K***V, i cili për periudhën 2007 – 2008 është taksuar me taksë si biznes i vogël për xhiron 2.000.001 - 3.000.000 lekë;
- certifikatë regjistrimi në organin tatimor e vitit 2005, me nr. serial ***, lëshuar nga Dega e Tatim-Taksave Durrës për aktivitetin biznes i vogël, me NIPT K***V, për Ols Dado dhe aktivitetin noter;
- vërtetim nr. *** prot., datë 30.5.2008, nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta për subjektin, i cili ka qenë punonjës në këtë institucion në harkun kohor 16.12.1995 – 15.2.1996;
- vërtetim datë 3.2.2005, nga Bashkia Durrës për subjektin, i cili ka qenë punonjës në këtë institucion për periudhën 29.1.1997 – 8.11.2000;
- vërtetim datë 5.6.2008, nga “A.M.C” sh.a. për subjektin, i cili ka qenë punonjës në këtë shoqëri në harkun kohor 16.2.1996 – 10.9.1996;
- vërtetim nr. *** prot., datë 2.6.2008, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për subjektin, i cili ka qenë punonjës në ish-Komisionin e Letrave me Vlerë për periudhën 1.7.2003 – 29.9.2005;
- vërtetim nr. *** prot., datë 16.8.2005, nga Komisioni i Letrave me Vlerë, sipas të cilit subjekti ka qenë punonjës në këtë institucion me pagë mujore *bruto* 59.500 lekë;
- librezë pune e subjektit.

35. Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se QKB-ja dhe DRT-ja Durrës konfirmojnë të njëjtat të dhëna, të cilat janë depozituar prej tij së bashku me deklaratën *Vetting*.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm janë llogaritur të ardhurat e subjektit për periudhën 1996 – 2008, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

Të ardhurat e subjektit për periudhën 1996 – 2008

Tabela nr. 2

| Të ardhurat e subjektit | Periudha 1996 – 2008 |
|--|-----------------------------|
| Punonjës pranë Ministrisë së Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta | 24,600.00 |
| Specialist në AMC | 91,993.00 |
| Specialist pranë Drejtorisë Ligjore | 345,796.00 |
| Specialist pranë ish-Komisionit të Letrave me Vlerë | 1,365,529.00 |
| Prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë | 0.00 |
| Prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec | 0.00 |

| | |
|--|---------------------|
| Të ardhura nga Këshilli i Evropës | 0.00 |
| Të ardhura nga SHBA | 0.00 |
| Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | 13,438.00 |
| Të ardhurat individuale si PF | 469,929.24 |
| Total të ardhurat nga paga I | 2,311,385.24 |
| Të ardhurat nga aktiviteti privat si noter II | 4,320,800.00 |
| Të ardhurat total (I+II) | 6,632,185.24 |

Nga tabela rezulton se të ardhurat e subjektit deri në momentin para fillimit të detyrës, që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, kanë qenë në shumën 6.632.185,24 lekë.

36. Në lidhje me burimin e dytë të deklaruar “*Depozituar nga babai shuma 34.800 euro, viti 2004. Aktiviteti privat i prindërve, pension i plotë pleqërie, shitje pasurish të paluajtshme*”

Për të provuar të ardhurat e ligjshme të prindërve të tij, subjekti ka depozituar:

- a. vendim nr. ***, datë 3.2.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për emërim të z. M. D si noter në këtë gjykatë;
- b. vërtetim datë 30.6.1992, nga Kolektivi i Avokatëve Durrës, sipas të cilit z. M.D, me vendim nr. *, datë 28.9.1991, të Këshillit Mbikëqyrës të Avokatisë, është emëruar avokat pranë ish-Kolegjit të Avokatëve Durrës, detyrë të cilën e ushtron prej datës 1.10.1991;
- c. vendim nr. ***, datë 31.8.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për regjistrimin e z. M.D si person fizik për të ushtruar veprimtarinë e tij si noter;
- d. shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti “M.D”, me NIPT K***F, aktivitete juridike, gjatë periudhës 1995 – 2006;
- e. shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës mbi të ardhurat e realizuara nga subjekti “R.D”, me NIPT K***H;
- f. vërtetim nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga ISSH-ja për z. M.D, i cili është pensionist prej datës 28.5.1992 dhe përfiton pension pleqërie në masën 18.434 lekë/muaj;
- g. vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, lëshuar nga ISSH-ja për znj. R.D, e cila është pensioniste prej datës 31.3.2003 dhe përfiton pension pleqërie në masën 14.785 lekë/muaj;
- h. disa kontrata shitjesh pasurish të paluajtshme⁹.

37. Nga hetimi në lidhje me këto të ardhura, ka rezultuar se:

- i. QKB-ja informon se:
 - a. Nëna e subjektit R.D figuron e regjistruar si person fizik me NIPT K***H, aktualisht me status “çregjistruar”. Me këtë NIPT rezulton se është pajisur gjithashtu me licencën me nr. LN-***, “Farmaci ose agjenci farmaceutike”.
 - b. Babai i subjektit M.D figuron:
 - i regjistruar si person fizik me NIPT K***F, aktualisht me status “pezulluar”;
 - i regjistruar likuidator i shoqërisë “A**-C” sh.p.k., me NIPT K***V;

⁹ Kontratë shitblerjeje datë 25.11.1991, për blerjen e objekteve, pronë e kooperativës, në shumën 441.330 lekë; kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 28.3.2005, sipas së cilës nëna e subjektit ka shitur pasurinë me sip. 120.7 m², si dhe pasurinë me sip. 26.8 m². Të dyja pasuritë e mësipërme janë shitur për shumën 500.000 lekë; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 30.1.2004, nëpërmjet së cilës subjekti dhe familjarët e tij kanë shitur apartament me sip. 86.73 m² (me origjinë nga privatizimi i banesave) në vlerën 1.000.000 lekë.

- të ketë qenë administrator në shoqërinë “D.H.L”, regjistruar në datën 9.1.2006 me NIPT K***C. Me aplikimin CN*** është larguar nga funksioni i administratorit pranë këtij subjekti;
- i regjistruar në firmën “F” sh.p.k., regjistruar në datën 3.5.1993, me vendimin nr. ***, të gjykatës. Për këtë aktivitet nuk gjendet NIPT;
- i regjistruar në firmën “F” sh.p.k., regjistruar në datën 3.5.1993, me vendimin nr. ***, të gjykatës. Për këtë aktivitet nuk gjendet NIPT.

ii. DRT-ja Durrës informon se babai i subjektit rezulton i regjistruar:

- a. Me NIPT K***F¹⁰. Objekti “aktivitete juridike”. Statusi “pasiv” që në datën 24.9.2014. Sipas të dhënave të sistemit c@ts rezulton se:

| Viti | Qarkullimi/lekë | Fitimi/lekë |
|------|-----------------|-------------|
| 2005 | 396,000 | 306,550 |
| 2006 | 0 | |

Nga kontrolli në arkivën e DRT-së Durrës rezultoi qarkullimi si vijon:

| Viti | Qarkullimi/lekë |
|------|-----------------|
| 1996 | 1,044,600 |
| 1997 | 525,902 |
| 1998 | 705,470 |
| 1999 | 2,000,000 |
| 2000 | 2,000,000 |
| 2001 | 2,000,000 |
| 2002 | 2,000,000 |
| 2003 | 1,132,000 |
| 2004 | 1,519,000 |

- b. Me NIPT K***F. Objekti “aktivitete juridike”. Statusi “pezulluar” që në datën 30.3.2017.
 c. Nëna e subjektit rezulton e regjistruar me NIPT K***H. Objekti i aktivitetit “tregtia me pakicë e produkteve farmaceutike”. Statusi “kërkesë për çregjistrim” që më 17.5.2013.

iii. Bashkia Durrës¹¹ informon se:

- a. Z. M.D ka qenë i regjistruar në sistem me NIPT K***F dhe rezulton i mbyllur në datën 30.3.2017. Nuk ka detyrime të palikuiduara në Bashkinë Durrës.
 b. Znj. R.D ka qenë e regjistruar në sistem me NIPT K***H dhe rezulton i mbyllur në datën 16.5.2013. Nuk ka detyrime të palikuiduara në Bashkinë Durrës.

iv. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës¹² informon se:

- a. Babai i subjekti përfiton pension pleqërie nga viti 1992.
 b. Nëna e subjektit përfiton pension pleqërie nga viti 2003.

¹⁰ Në lidhje me të ardhurat nga ky NIPT shihni dhe shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2017, të DRT-së Durrës administruar nga ILDKPKI-ja.

¹¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.10.2017, nga Bashkia Durrës, administruar ILDKPKI-ja dhe shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2022.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2022.

Kjo drejtori ka vënë në dispozicion në mënyrë analitike përfitimin e pensionit të prindërve të subjektit nga momenti i përfitimit deri aktualisht.

38. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm janë llogaritur të ardhurat e babait të subjektit për periudhën 1992 – 2016, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

a. Të ardhurat e babait të subjektit për periudhën 1992 – 1996 janë si vijon:

Tabela nr. 3

| Të ardhura e babait të subjektit M. D | 1992 – 2016 |
|--|----------------------|
| Të ardhura nga pensioni | 2,817,965.00 |
| Të ardhura nga paga | 915,933.32 |
| Të ardhura nga aktiviteti privat si noter | 9,388,024.00 |
| Total | 13,121,922.32 |

Për të ardhurat e babait të subjektit si person fizik në analizë është konsideruar një marzh fitimi në masën 60% për periudhën 1995 – 2010, duke iu referuar marzhit mesatar të fitimit të viteve pasardhëse.

b. Të ardhurat e nënës së subjektit për periudhën 1992 – 2016 janë si vijon:

Tabela nr. 4

| Të ardhurat e nënës R.D | 1992 – 2016 |
|----------------------------------|----------------------|
| Të ardhura nga pensioni | 1,702,849.00 |
| Të ardhura nga paga | 1,833,491.24 |
| Të ardhura nga aktiviteti privat | 12,706,211.70 |
| Total | 16,242,551.94 |

Për të ardhurat e nënës së subjektit si person fizik në analizë është konsideruar një marzh fitimi në masën 45% duke iu referuar marzhit mesatar të fitimit të viteve pasardhës.

Analiza financiare

39. Komisioni gjatë hetimit ka konstatuar se pagesat për kryerjen e këtij apartamenti janë kryer përpara fillimit të detyrës së subjektit, por pavarësisht këtij fakti, me qëllim arritjen e një konkluzioni sa më të saktë në lidhje me kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, është analizuar në detaje mundësia për kryerjen e këtyre pagesave, për sa kohë kemi të bëjmë me një pasuri që është deklaruar në deklaratën *Vetting*.

40. Në vitin 2004 subjekti ka kryer pagesat si vijon:

- lajmërim debitimi pranë Bankës Amerikanë të Shqipërisë për transferimin e shumës 10.600 USD në datën 19.1.2004;
- lajmërim debitimi pranë Bankës Amerikanë të Shqipërisë për transferimin e shumës 22.354 USD në datën 19.1.2004;
- mandatarkëtim nr. ***, datë 10.12.2004, i shoqërisë “K.A”, të shumës 7.310 euro, paguar nga subjekti.

Analiza financiare mbi shumën e paguar nga subjekti dhe ish-bashkëshortja në vitin 2004

Tabela nr. 5

| | Kumulative 1999 – 2004 |
|--|-------------------------------|
| Pasuria | 9,508,707.21 |
| Apartament me sip. 115.89 m ² | 9,505,500.00 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | 3,207.21 |
| Detyrime | 5,462,241.28 |
| Detyrimi ndaj firmës ndërtuese “K.A” sh.p.k. | 9,505,500.00 |
| Shlyerje detyrimi ndaj firmës ndërtuese “K.A” sh.p.k. | -4,043,258.72 |
| Pasuria neto | 4,046,465.93 |
| Të ardhurat | 5,931,327.45 |
| Të ardhurat e subjektit nga paga | 1,079,964.00 |
| Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat si noter | 0 |
| Të ardhurat e ish-bashkëshortes si notere | 4,202,460.00 |
| Të ardhurat e ish-bashkëshortes | 398,903.45 |
| Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme | 250,000.00 |
| Shpenzime | 1,935,702.60 |
| Shpenzime jetike | 1,496,548.50 |
| TIMS | 439,154.10 |
| Mundësia për kursime | -50,841.08 |

41. Në analizën financiare për periudhën 1999 – 2004 janë konsideruar:

- të ardhurat e subjektit nga paga në vlerën 1.079.964 lekë dhe ish-bashkëshortes nga paga në vlerën 398.903,45 lekë;
- të ardhurat e ish-bashkëshortes nga aktiviteti privat si notere në vlerën 4.202.460 lekë;
- të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, pjesa takuese ¼ e vlerës 1.000.000 lekë nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2004, midis familjes D dhe shtetasit B.B;
- shpenzimet jetike janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave të përfituara nga paga për periudhën 1999 – 2000 dhe për periudhën 2000 – 2004 për 3 persona.

42. Nga analiza financiare subjekti dhe bashkëshortja e tij rezultojnë me një rezultat negativ në shumën 50.841,08 lekë. Në lidhje me këtë rezultat negativ, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin e mospërfshirjes në analizë të mundësisë së kursimit të subjektit dhe prindërve të tij deri në momentin e martesës së subjektit, në vlerën rreth 3,000,000 lekë, vlerëson se nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi kemi të bëjmë me një vlerë të papërfillshme.

43. Në vitet 2006 dhe 2007 subjekti ka kryer pagesat e mëposhtme:

- mandatdepozitimin datë 1.6.2006, pranë “Raiffeisen Bank” të shumës 3.000 euro, në favor të llogarisë “K.A”;
- mandatdepozitimin datë 11.6.2007, pranë “Raiffeisen Bank” të shumës 3.000 euro, në favor të llogarisë “K. A”, me përshkrimin “derdhje këst apartamenti”.

Analiza për shlyerjen e pjesshme të këstit në vitet 2006 dhe 2007

Tabela nr. 6

| | Datë 1.6.2006 | Datë 11.6.2007 |
|--|----------------------|-----------------------|
| Pasuria | -129,912.72 | 227,582.02 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | -129,912.72 | 227,582.02 |
| Detyrime | -491,109.00 | -482,730.00 |
| Shlyerje detyrimi ndaj firmës ndërtuese | -371,109.00 | -362,730.00 |
| Kredi M dhe R.D, viti 2005, shuma 1 milion | -120,000.00 | -120,000.00 |

| | | |
|--|---------------------|---------------------|
| Pasuria neto | 361,196.28 | 710,312.02 |
| Të ardhurat | 1,176,043.56 | 1,508,554.52 |
| Të ardhurat e subjektit nga paga | 68,342.26 | 70,009.92 |
| Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat si noter | 901,900.00 | 756,000.00 |
| Të ardhurat e babait të subjektit (pensioni + paga) | 86,306.15 | 74,949.00 |
| Të ardhurat e babait të subjektit si noter | 0.00 | 240,000.00 |
| Të ardhurat e nënës së subjektit (pensioni + paga) | 119,495.16 | 117,595.60 |
| Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme | | 250,000.00 |
| Shpenzime | 465,344.00 | 269,930.00 |
| Shpenzime jetike | 164,335.50 | 204,930.00 |
| TIMS | | |
| Shpenzime mobilimi | 200,000.00 | 0.00 |
| Kontribut për djalin K.D | 101,008.50 | 65,000.00 |
| Mundësia për kursime | 349,503.28 | 528,312.50 |

44. Në analizën financiare për vitet 2006 - 2007 janë konsideruar:

- të ardhurat e subjektit nga paga në vlerën 68.342,26 lekë për vitin 2006 dhe të ardhurat e subjektit nga paga në vlerën 70.009,92 lekë për vitin 2007;
- të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat si noter në vlerën 901.900 lekë për vitin 2006 dhe në vlerën 756.000 lekë për vitin 2007;
- të ardhurat e prindërve nga pagat dhe pensionet në vlerën 119.495,15 lekë për vitin 2006 dhe në vlerën 117.595,60 lekë për vitin 2007;
- të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, pjesa takuese $\frac{1}{4}$ e vlerës 1.000.000 lekë nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2004, midis familjes D dhe shtetasit B.B;
- të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme, kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.2007, sipas së cilës nëna e subjektit R.D ka shitur pasurinë nr. ***-N*, njësi me sip. 120.7 m², në Xh, Shijak, Durrës, blerësit S.Gj, në çmimin 250.000 lekë;
- shpenzimet për kontribut ndaj djalit K.D;
- shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 3 persona.

45. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e pagesave në shumën 6.000 euro.

46. Babai i subjektit, me mandatarkëtimin nr. ***, datë 30.9.2004, ka paguar shumën 34.800 euro.

Analiza financiare për shumën 34.800 euro

Tabela nr. 7

| | |
|---|-------------------------|
| | 1992 – 30.9.2004 |
| Pasuria | 2,053,563.64 |
| Pasuri e ndërtuar | 2,022,952.69 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | <i>30,610.95</i> |
| Detyrime | 0.00 |
| Pasuria neto | 2,053,563.64 |
| Të ardhurat | 15,406,590.79 |
| Të ardhurat e babait të subjektit (pensioni + paga) | 917,326.13 |
| Të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti “noteri” | 6,024,474.00 |

| | |
|---|---------------------|
| Të ardhurat e nënës së subjektit (pensioni + paga) | 767,285.48 |
| Të ardhurat e nënës së subjektit nga aktiviteti “farmaci” | 6,872,505.19 |
| Të ardhurat e përfituara nga shitja e njësisë “shesh-lokal” në Xh, me sip. 79.8 m ² | 325,000.00 |
| Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme pjesa takuese ¼ e vlerës 1,000,000 lekë | 500,000.00 |
| Shpenzimet | 6,541,262.05 |
| Shpenzime jetike | 1,330,710.05 |
| TIMS | 0.00 |
| Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.4.2003, blerja e njësisë “lokal” nga R. D | 800,000.00 |
| Pagesë e kështit për apartamentin O. D 34,800 euro | 4,410,552.00 |
| Mundësia për kursime | 6,811,765.11 |

47. Në analizën financiare për periudhën 1992 – 30.9.2004 janë konsideruar:

- të ardhurat e prindërve nga pagat dhe pensionet, në total 1.684.611,60 lekë;
- të ardhurat e prindërve nga aktiviteti privat, në total 12.896.979,19 lekë;
- të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme, në total 825.000,00 lekë;
- shpenzimet për blerjen e pasurive të paluajtshme në vlerën 800.000 lekë;
- shpenzimet jetike janë përlogaritur në masën 66% të të ardhurave të përfituara nga paga për periudhën 1992 – 2000 dhe për periudhën 2000 – 2004 për 3 persona.

Nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të paguar shumën 34.800 euro.

48. Në përfundim në lidhje me këtë apartament konstatohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e tij.

49. Automjet tip “Volkswagen Golf *”¹³**, me targa AA *** MC (targa e mëparshme DR *** E). Data e blerjes: 10.4.2008. Vlera: 14.700 euro. Likuiduar tërësisht para fillimit të detyrës. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: aktiviteti privat 2005 - 2008, pagat 1995 - 2005, shitje ¼ pjesë e pandarë apartament banimi, bashkëjetesa me prindërit deri në vitin 2008.

Hetimi¹⁴/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

50. Subjekti, me faturën tatimore të shitjes nr. ***, datë 10.4.2008, ka blerë nga shoqëria “C” sh.p.k. automjetin tip “V.G” në vlerën 14.700 euro, konvertuar në 1.822.800 lekë.

Bazuar në deklaratën doganore Import 4 rezulton se shoqëria e ka blerë automjetin në datën 8.4.2008, në shumën 11.648,09 euro dhe ka paguar detyrime doganore në shumën 288.181 lekë.

51. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2008 subjekti ka deklaruar *autoveturë “V. G”, 2008, blerë, tek “C” sh.p.k. aktivitet privat.*

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 10.4.2008; (ii) deklaratë zhdoganimi të automjetit.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2020, e DPSHTRR-së.

52. Subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin¹⁵ e datës 13.1.2016 pranë ILDKPKI-së në lidhje me këtë automjet, ka deklaruar: “Burimi i krijimit janë nga aktiviteti im privat si noter... përveç aktivitetit tim privat si noter edhe babai, nëna dhe ish-bashkëshortja kanë ushtruar aktivitetet privat, si rrjedhim të gjitha të ardhurat familjare janë nga këto aktivitete”.

Analiza financiare për automjetin tip “Volkswagen Golf *”

Tabela nr. 8

| | Datë 10.4.2008 |
|--|-----------------------|
| Pasuria | 1,075,709.27 |
| Automjet Volkswagen Golf *, datë 10.4.2008 | 1,822,800.00 |
| Ndryshim likuiditeti | -747,090.73 |
| <i>Total likuiditeti</i> | <i>1,484,056.42</i> |
| Detyrime | 0 |
| Pasuria neto | 1,075,709.27 |
| Të ardhurat | 1,512,000.00 |
| Të ardhurat e subjektit nga paga | 0 |
| Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat si noter | 1,512,000.00 |
| Shpenzimet | 85,540.00 |
| Shpenzime jetike | 45,540.00 |
| TIMS | 0 |
| Kontribut për djalin K. D | 40,000.00 |
| Mundësia për kursime | 350,750.73 |

53. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti e ka shitur këtë automjet në datën 12.3.2018, me kontratën nr. ***, në shumën 3.800 euro.

54. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

55. **Depozitë kursimi në “Raiffeisen Bank”**¹⁶, hapur në vitin 2005. Fillimisht llogari e lirë, më 27.7.2009, kthyer në depozitë kursimi. Vlera: 1.028.271 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: aktiviteti privat 2005 - 2008, pagat 1995 - 2005, shitje ¼ pjesë e pandarë apartament banimi.

Hetimi¹⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

56. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 27.7.2009 është hapur depozita në shumën 900.000 lekë. Kjo depozitë për çdo vit është shtuar me interesat dhe në datën 29.3.2016 ka qenë në vlerën 1.028.271,73 lekë.

57. Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2008 subjekti ka deklaruar llogarinë e lirë nr. ***-ALL-*** në “Raiffeisen Bank”, e cila ka shërbyer:

- si llogari page për punësimin e subjektit në Komisionin e Letrave me Vlerë;

¹⁵ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.9.2020, nga ILDKPKI-ja.

¹⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) pasqyrën përmbledhëse të referencave bankare nr. ***, të klientit Ols Dado pranë “Raiffeisen Bank” dhe veprimeve të kryera ndër vite; (ii) nxjerrje të llogarisë personale nr. ***, në “Raiffeisen Bank”, nga data 13.10.2015 deri më 13.10.2016.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.10.2020, e “Raiffeisen Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.9.2020, Raiffeisen Invest.

- për depozitimet nga aktiviteti privat në vitet 2007 - 2008 në vlerën 720.199 lekë.

58. Analiza financiare

Tabela nr. 9

| | Datë 27.7.2009 |
|---|-----------------------|
| Pasuria | 15,754.91 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | <i>15,754.91</i> |
| Detyrime | 0.00 |
| Pasuria neto | 15,754.91 |
| Të ardhurat | 531,084.55 |
| Të ardhurat e subjektit nga paga | 531,084.55 |
| Shpenzimet | 246,223.43 |
| Shpenzime jetike | 79,695.00 |
| TIMS | 14,861.77 |
| Shpenzime për qëndrim jashtë vendit të banimit për shkaqe pune, janar 2009 – shtator 2009, Pogradec | 81,666.67 |
| Kontribut për djalin K.D | 70,000.00 |
| Mundësia për kursime | 269,106.21 |

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

59. Kjo depozitë, sipas deklaratës *Vetting*, ka shërbyer për blerjen e kuotave në Fondin Prestigj të Raiffeisen Invest. Raiffeisen Invest informon se subjekti ka investuar në Fondin Prestigj dhe në datën 22.9.2020 gjendja në fond është 1.046.271,75 lekë. Subjekti në datën 5.3.2019 ka blerë 681, 4413 kuota për shumën 1.028.446 lekë.

Nga hetimi konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

60. Depozitë kursimi në “Tirana Bank”¹⁸, hapur në vitin 2007. Fillimisht llogari e lirë, në tetor të vitit 2008, kthyer në depozitë kursimi. Vlera: 1.229.153 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: aktivitet privat në vitet 2005 – 2008; pagat në vitet 1995 – 2005; shitje ¼ pjesë e pandarë apartament banimi.

Hetimi¹⁹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

61. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Tirana Bank” rezulton se:

- Në datën 13.10.2008 subjekti ka depozituar shumën 776.000 lekë dhe në datën 16.12.2008 shumën 535.500 lekë.
- Në datën 16.12.2008 gjendja e kësaj llogarie rezulton të jetë 1.311.645,00 lekë. Në këtë datë subjekti kryen transferim fondi në vlerën 1.000.000 lekë për hapjen e depozitës me afat 12-mujor.

Në deklaratën *Vetting* kjo depozitë rezulton të jetë në shumën 1.229.153,85 lekë.

62. Analiza financiare

¹⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje e llogarisë nr. *** EA, në emër të z. Ols Dado pranë “Tirana Bank”, për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2013.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.9.2020, nga “Tirana Bank”.

Tabela nr. 10

| | Datë 16.12.2008 |
|--|------------------------|
| Pasuria | -1,642,962.05 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | -1,642,962.05 |
| Detyrime | 0.00 |
| Pasuria neto | -1,642,962.05 |
| Të ardhura | 673,127.54 |
| Të ardhurat e subjektit nga paga | 13,127.54 |
| Të ardhurat e subjektit nga aktiviteti privat si noter | 660,000.00 |
| Shpenzime | 42,770.00 |
| Shpenzime jetike | 22,770.00 |
| Kontribut për djalin K.D | 20,000.00 |
| Mundësia për kursime | 2,273,319.59 |

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

Në përfundim konkludohet se subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

63. Depozitë kursimi në “Intesa Sanpaolo Bank”²⁰, hapur në vitin 2007. Vlera: 7.524 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: aktivitet privat 2005 – 2008; pagat 1995 – 2005; shitje ¼ pjesë e pandarë apartament banimi.

64. Depozitë kursimi në “Intesa Sanpaolo Bank”, hapur në vitin 2016. Hapur më parë më 21.8.2007, në “Raiffeisen Bank”. Transferuar në “Intesa Sanpaolo Bank” për shkak të interesave. Shuma fillestare: 3.923 euro. Shtuar me 10.500 euro, nga të cilat 7.500 euro dhuratë nga nëna + 3.000 euro kursime nga paga. Vlera e depozitës: 14.689 euro. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: (i) aktivitet privat në vitet 2005 – 2008, pagat në vitet 1995 – 2005, shitje ¼ pjesë e pandarë apartament banimi; (ii) dhuratë nga nëna; (iii) kursime nga paga.

Hetimi²¹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

65. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se në datën 14.11.2007 ka depozituar shumën 6.600 euro, e cila është ka kaluar në depozitë. Aktualisht gjendja e depozitës është 7.524,79 euro.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) dokument referues të pozicionit të përgjithshëm të klientit Ols Dado, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”; (ii) *statement* të llogarisë personale Ols Dado me nr. ***, për periudhën 1.1.2007 – 13.9.2016; (iii) nxjerrje të llogarisë personale nr. *** në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 27.7.2009 – 12.10.2015; (iv) nxjerrje të llogarisë personale nr. *** në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 13.10.2015 - 13.10.2016; (v) kërkesë për thyerje të depozitës me afat me vlerë 14.687,62 euro, lidhur në datën 14.4.2015 nga klienti me nr. ***, në “Raiffeisen Bank”; (vi) deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.4.2013; (vii) kontratë shitblerjeje nr. ***.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.10.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

66. Në datën 1.4.2016 subjekti ka depozituar në llogarinë e tij në ISP Bank shumën 14.689 euro²², ku si burim është deklaruar tërheqja nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”.

67. Në DPV/2013 subjekti ka deklaruar: “*Depozitë kursimi pranë ‘Raiffeisen Bank’ shtuar nga derdhje në vlerën 10.500 euro 7.500 euro, përfitur nga dhurimi dhe kursimet vjetore konvertuar në vlerën 3.000 euro. Shuma e përfitur është siguruar nga shitja e një sipërfaqeje toke truall në bashkëpronësi të nënës time R.D*”.

Në lidhje me burimin e kësaj depozite nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në euro në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 18.12.2008 subjekti ka çelur depozitë në shumën 3.980,7 euro, e cila ka vijuar deri më 11.4.2013, ku është shtuar edhe shuma 10.500 euro, e cila është depozituar *cash* nga subjekti në po të njëjtën datë. Në këtë vit depozita ka qenë në vlerën 14.668,55 euro, e cila është tërhequr në datën 1.4.2016.

68. Nëna e subjektit, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.4.2013, ka deklaruar se i ka dhuruar subjektit shumën 7.500 euro, e cila rrjedh nga shitja e truallit prej 35.9 m², që ajo dhe bashkëpronarët e tjerë të kësaj pasurie kanë trashëguar nga gjyshja e tyre. Ky truall ndodhet në qytetin e Tiranës, mbrapa Pallatit të Kulturës.

69. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 18.2.2013 nëna e subjektit, së bashku me familjarët e saj, me kontratë shitblerjeje nr. ***, kanë shitur një truall me sip. 35.9 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, për shumën 4.308.000 lekë. Ky truall është fituar nga nëna e subjektit me trashëgimi.

70. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kursimet në shumën 3.000 euro.

Në përfundim konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

71. Truall (në bashkëpronësi ¼ pjesë e pandarë)²³ me sipërfaqe 69.2 m², nga e cila 31 m² ndërtesë e vitit 1922, me adresë: rruga “A. Z. Çajupi”, nr. pasurie *, z. k. ***, Tiranë.**

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kontratë dhurimi noteriale me palë dhuruese R.D (nëna e subjektit).

Hetimi²⁴/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

72. Subjekti, bazuar në certifikatën e pronësisë nr. ***, është bashkëpronar me ¼ pjesë takuese të pasurisë truall me sip. 277 m² dhe ndërtesë me sip. 124 m², regjistruar me nr. ***, z. k. ***, Tiranë.

Subjekti e ka përfitur këtë pasuri²⁵ nga nëna e tij me kontratë dhurimi të pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 4.5.2016.

²² Deklaruar në DPV/2016.

²³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, (ii) kontratë dhurimi e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2016; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar më 19.2.2013; (iv) vendim datë 30.1.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; (v) kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2016.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.12.2020, Drejtoria Vendore Tirana Veri; shkresë nr. *** prot., datë 21.6.2022, drejtuar ASHK Tirana Veri; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.6.2022, ASHK Tirana Veri.

²⁵ Deklaruar në DPV/2016.

Origjina e kësaj pasurie dhe e pasurisë më lart²⁶ (e cila ka shërbyer si burim për dhurimin e shumës 7.500 euro) rrjedh nga dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshuar në datën 30.1.2013, me vendim nr. *** nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore:

- për të ndjerën R.B (nëna e znj. R.D) nëna e subjektit ka trashëguar ½ pjesë të pasurisë;
- për të ndjerën K.B (motra e nënës së znj. R.D) nëna e subjektit ka trashëguar 1/6 pjesë të pasurisë;
- për të ndjerin S.B (vëllai i nënës së znj. R.D) nëna e subjektit ka trashëguar ¼ pjesë të pasurisë.

73. Në seksionin “të dhëna konfidenciale të deklaratës *Vetting*” subjekti, në lidhje me truallin, ka deklaruar: *“Në lidhje me pasurinë ‘truall’, përshkruar më lart, është nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë e ndërtimit ‘R’ sh.p.k., me qëllim sigurimin e lejes së ndërtimit për një objekt banimi. Kontrata është nënshkruar edhe nga bashkëpronarët e tjerë të pasurisë. Leja e ndërtimit nuk është siguruar”.*

74. Subjekti, së bashku me pronarët e tjerë të truallit, kanë lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 25.10.2016, me objekt ndërtimin e një godine shumëkatëshe banimi dhe shërbimi. Sipas kësaj kontrate, sipërfaqja ndërtimore që do të përfitojë dhe kalojnë në pronësi të palës pronare do të jetë 43%.

Në DPV/2017, subjekti deklaroi se kontrata e sipërmarrjes është revokuar me shoqërinë “R” sh.p.k. Për të provuar këtë deklaram, subjekti ka depozituar dokumentin “revokim kontratë sipërmarrjeje” nr. ***, datë 12.10.2017, sipas të cilit është revokuar kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 25.10.2016.

75. Nga verifikimi i kartelës së pasurisë u konstatua së kishte një shënim për një ndërtim pa leje. Subjekti, i pyetur nga Komisioni në lidhje me ndërtimin pa leje të përshkruar në kartelën e pasurisë, ka deklaruar²⁷: *“Mendoj se për shkak të gjendjes së keqe fizike të ndërtesës ekzistuese së regjistruar prej 124 m², provuar kjo me raportin teknik që po bashkëngjis, djali i dajës së nënës time, shtetasi Z.B, një nga banorët e përhershëm të ndërtesës ka kryer ndërtimin e përmendur më sipër në oborrin e kësaj të fundit, pra mbi truallin prej 227 m². Ndërtimit të cilit ju i referoheni si pa leje është realizuar nga ky shtetas, i cili ka jetuar në këtë banesë së bashku me bashkëshorten dhe dy vajzat e tij. Aq i vërtetë është ky fakt sa në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 16.2.2018²⁸, firma ‘A-E’ sh.p.k., e cila aktualisht po zhvillon pronën në fjalë, ka marrë përsipër të paguajë qiranë mujore duke strehuar familjen e z. Z.B deri në dorëzimin e ambienteve që përfiton sipas kësaj kontrate, duke i dhënë 600,000 lekë në vit ... Ju bëj me dije se pasuria në fjalë më është dhuruar nga nëna ime me datën 4.5.2016. Kontratës së dhurimit i është bashkëngjitur certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë datë 19.2.2013, në pjesën e pasme të së cilës ekziston përshkrimi ‘ndërtim pa leje’. Pra, provohet që ky ndërtim ka ekzistuar të paktën para vitit 2013, ndërkohë që pasuria më është dhuruar në vitin 2016”.*

76. Në lidhje me ndërtimin pa leje të përshkruar në kartelën e pasurisë nr. ***, ASHK-ja informon se nga verifikimi i regjistrave hipotekorë rezultoi se në datën 17.11.2006 ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar. Shënimi në seksionin “përshkrim i veçantë” të

²⁶ Shihni pikën 69 të këtij vendimi.

²⁷ Përgjigje pyetësores datë 29.6.2022.

²⁸ Kjo kontratë është administruar nga Komisioni me kërkesën nr. *** prot., datë 21.6.2022, drejtuar noterit A. S; shkresë kthim përgjigjeje datë 23.6.2022 e noterit A.S.

kartelës së pasurisë vjen si verifikim në terren i ndërtimit pa leje nga shoqëria që ka kryer procesin e regjistrimit fillestar. Ky fakt rezultoi edhe sipas hartës së ASIG-ut të vitit 1994. Ndërtimi pa leje nuk rezultoi të ketë dokumentacion ligjor të depozituar pranë ASHK-së.

Gjithashtu, nga verifikimi në bazën dixhitale të informacionit mbi vetëdeklarimet e ndërtimeve pa leje që disponon kjo drejtori, nuk rezultoi të ketë objekte në proces legalizimi mbi pasurinë nr. ***.

77. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

78. Llogari në “Credins Bank”²⁹, ku depozitohet paga mujore. Gjendja e llogarisë në datën 19.1.2017 është 55.582,37 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi³⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

79. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Credins Bank” rezultoi se gjendja në datën 19.1.2017 është 55.582,37 lekë.

Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

Në lidhje me pasuritë e deklaruara të djalit të subjektit të rivlerësimit

80. Llogari “Futura”³¹, hapur nga deklaruesi në emër të djalit K.D, i datëlindjes 20.9.1999

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: detyrim që rrjedh nga vendimi nr. ***, datë 9.2.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Detyrimi mujor: 10.000 lekë. Shuma e përgjithshme e depozituar deri në këtë moment: 1.784.780 lekë.

81. Llogari “Futura”³², hapur në emër të djalit K.D, nga nëna e tij (ish-bashkëshortja) G. B, datë 11.4.2008. Shuma e përgjithshme e depozituar: 1.620,32 euro.

Hetimi³³/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

82. Nga nxjerrja e llogarisë së djalit të subjektit K.D në “Intesa Sanpaolo Bank” gjendja e kësaj llogarie është në shumën 1.784.780 lekë. Në këtë llogari është depozituar periodikisht nga subjekti ose nëna e subjektit pagesa e pensionit ushqimor. Kjo pagesë është vendosur me vendimin nr. ***, datë 27.1.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me palë paditëse shtetasen G.B dhe palë të paditur shtetasin Ols Dado, me objekt “zgjidhje martesë”, në të cilën gjykata, përveç të tjerave, ka vendosur detyrimin e subjektit të paguajë pension ushqimor për fëmijën në shumën 10.000 lekë/muaj.

83. Nga nxjerrja e llogarisë së djalit të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezultoi se nëna e tij, znj. G.B, ka kryer depozitime të vazhdueshme në këtë llogari deri në datën 1.6.2009, në një

²⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës lëvizjet e llogarisë në “Credins Bank”, gjatë periudhës 4.1.2017 - 19.1.2017.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.12.2020 “Credins Bank”.

³¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) *statement* të llogarisë me nr. *** në emër të shtetasit K.D, në “Intesa Sanpaolo Bank”, për periudhën 1.1.2005 – 4.1.2017; (ii) vendim nr. ***, datë 27.1.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

³² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) *statement* të llogarisë nr. *** në emër të shtetasit K.D, në “Intesa Sanpaolo Bank”, për periudhën 1.1.2005 – 4.1.2017.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, drejtuar bankave; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

shumë totale prej 1.339,55 euro. Më pas, në këtë llogari janë shtuar interesat vjetore dhe më 31.3.2016 gjendja ka qenë në shumën 1.625,42 euro.

Nga hetimi pas deklaratës *Vetting* rezulton se djali i subjektit, në vitin 2017, ka tërhequr shumën 1.330 euro.

84. Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këto depozita dhe se subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

85. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

86. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Ols Dado nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohesh parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

87. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ols Dado ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

88. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ols Dado, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

89. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin³⁴ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ols Dado, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

90. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

91. Komisioni kreu një hetim³⁵ të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit Ols Dado, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi

³⁴ Raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017.

³⁵ Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

92. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ols Dado ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

93. Në periudhën shtator 2005 – nëntor 2008 subjekti i rivlerësimit ka punuar si noter në Dhomën Kombëtare të Noterëve Durrës.

Me Dekretin Nr. ***, datë 17.11.2008, të Presidentit të Republikës, subjekti i rivlerësimit Ols Dado është emëruar prokuror. Në periudhën nëntor 2008 - shtator 2009, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Në periudhën shtator 2009 – janar 2020, subjekti ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. 7, datë 21.1.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit është komanduar në pozicionin e ndihmës magjistratit në Prokurorinë e Përgjithshme.

94. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe analiza e Komisionit

95. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

96. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave të dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së.

97. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

98. Nga shqyrtimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitur nga subjekti, si edhe pesë dosjeve hetimore të përzgjedhura me short, Komisioni nuk konstatoi problematika.

Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

99. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit rezulton se:

- Nga të dhënat që ndodhen në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Ols Dado.
- Ndaj subjektit të rivlerësimit Ols Dado ka pasur 4 kallëzime penale të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

100. Sektori protokoll - arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2020, bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2018 rezulton se ka pesë ankesa. Këto ankesa rezulton të jenë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila ka informuar ankuesit se kompetente për të vlerësuar vendimmarrjen e prokurorit, kur është ushtruar ankim në gjykatë, është vetëm gjykata.

101. Pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së subjektit, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

Konkretisht janë administruar:

- i. vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit” i vitit 2014, për prokurorin Ols Dado në nivel “shumë mirë”;
- ii. vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit” i vitit 2015, për prokurorin Ols Dado në nivel “shumë mirë”;
- iii. vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit” i vitit 2016, për prokurorin Ols Dado në nivel “shumë mirë”.

ANALIZA E GJETJEVE

102. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe të dhënave nga burimet arkivore në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatim të ligjit. Ai analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Subjekti ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore.

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi pasqyrim të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimit të rrethanave të faktit. Konkluzioni i subjektit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e elementeve të figurës së veprës penale. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale objekt hetimi.

Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv. Ai merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

Dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal dhe me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe disponimin e gjykatës.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Subjekti i rivlerësimit rezulton t'i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, duke marrë pjesë në një seminar. Formularit të vetëvlerësimit i është bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Shkolla e

Magjistraturës, si dhe kopje të certifikatave të trajnimeve për pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të Programit të Trajnimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në formular pjesëmarrjen në 9 trajnime të kryera jashtë periudhës së rivlerësimit. Formularit të vetëlvlerësimit i janë bashkëlidhur kopje të certifikatave, që të vërtetojë kryerjen e këtyre trajnimeve.

Denoncime

103. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar tri denoncime të paraqitura në Komision. Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, për shkak të këtyre denoncimeve, subjekti i janë kërkuar shpjegime për dy denoncime si në vijim:

1. Denoncim i shtetasit A.K³⁶

Denoncuesi ankohet lidhur me vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit për pushimin e hetimeve ndaj grupit të strukturuar kriminal që falsifikonte vizat amerikane në Shqipëri. Ai ka vënë në dispozicion të Komisionit kopjen e vendimit për “pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2010”. Nga shqyrtimi i këtij vendimi rezulton se materiali kallëzues është regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “mashttrim”.

Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të autorizojë kryerjen e përgjimeve të bisedave, si dhe përgjimin e fshehtë fotografik e filmik. Nga bisedat e regjistruara duket se veprimet e shtetasve ndaj të cilëve janë kryer përgjimet synojnë përgatitjen e një skeme, e cila do të konkludonte në përvetësimin e shumës së të hollave nga kallëzuesi. Asnjë provë apo rrethanë e faktit nuk sugjeron ndonjë person kontakti apo njohje të drejtpërdrejtë të këtyre shtetasve me ndonjë funksionar të huaj, në rastin konkret, të Ambasadës së SHBA.

Në vendim argumentohet se veprimet e shtetasve të vendosur nën përgjim dëshmojnë për pjekjen e një mendimi kriminal me synim mashttrimin e kallëzuesit, por nuk kanë konkluduar, duke i përjashtuar këta shtetas nga përgjegjësia penale. Në vijim është vendosur pushimi i hetimeve për procedimin penal.

Në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegimet në lidhje me këtë denoncim, si dhe të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur në vijimësi në dosjen objekt procedimi.

Në lidhje me këtë denoncim, subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit³⁷, ka sqaruar: *“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi A.K, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 7.10.2010, me objekt hetimin e veprës penale ‘mashttrim’, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.*

Referuar kallëzimit penal, shtetasi A.K ka pretenduar që një shtetas kanadez dhe disa shtetas shqiptarë i kanë kërkuar një shumë të hollash prej 15.000 euro për të bërë të mundur lëshimin e një vize për në SHBA. Sipas kallëzuesit, viza do të lëshohej brenda datës 20.10.2010 dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të udhëtonte si pjesë e një grupi artistësh (në rolin e këngëtarit apo valltarit) në kuadër të festimeve të 28 - 29 nëntorit, organizuar nga Ministria e Kulturës tonë, pas ftesës së mbërritur nga pjesë të diasporës shqiptare në atë vend.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 3.9.2020.

³⁷ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

Pas regjistrimit të procedimit penal dhe pas gatishmërisë së shtetasit A.K për të regjistruar bisedat me shtetasit e përmendur në kallëzim, bazuar në nenet 221/1/a dhe 222/1 të Kodit të Procedurës Penale, nga ana ime si prokuror i çështjes u vendos të autorizohet kryerja e përgjimeve të bisedave në vende publike, si dhe përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video, mes personit të autorizuar A.K dhe shtetasve J.W.P dhe atij të quajtur M, për një afat kohor prej 15 ditësh, i cili më pas është zgjatur edhe për një periudhë tjetër 15-ditore.

Nga të gjitha bisedat e regjistruara, si dhe nga deklaratimet e kallëzuesit, duket se veprimet e shtetasve E.Sh dhe S.C synonin në përgatitjen e një skeme, e cila do të konkludonte në përvetësimin e shumës së të hollave nga kallëzuesi. Asnjë e dhënë konkrete, provë apo rrethanë e faktit nuk na sugjeroi ndonjë person kontakti apo njohje të drejtpërdrejtë të shtetasve të sipërpërmendur me ndonjë funksionar të huaj, në rastin konkret, të Ambasadës së SHBA-së. Duket se ka qenë qëllimi i shtetasve të përfshirë në ngjarje që, nëpërmjet gënjeshtërisë, të arrinin të merrnin nga kallëzuesi shumën e të hollave. Por, veprimet e tyre, të cilat dëshmojnë për pjekjen e një mendimi kriminal me synim mashtrimin e kallëzuesit, me gjithë mundësinë për kryerjen veprës penale, nuk kanë konkluduar, duke i përjashtuar këta shtetas nga përgjegjësia penale.

*Ky ka qenë përfundimi i arritur nga ana ime, si prokuror i çështjes, duke u bazuar edhe në përgjigjen e ardhur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Kjo e fundit, në përgjigje të interesimit të organit të akuzës, me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2011, ka bërë me dije se ky dikaster nuk kishte bërë asnjë notë verbale, me anën e së cilës i kërkohej vizë hyrje për ndonjë person apo grup personash, pranë Ambasadës së SHBA-së.*

Veç kësaj, nisur nga ndjeshmëria që paraqiste situata e pretenduar nga shtetasi A.K, në funksion të një hetimi shterues në drejtim të zbulimit të një kontakti të referuar nga kallëzuesi, i cili supozohej se punonte pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, kësaj të fundit (Zyrës Rajonale të Sigurimit) i është dërguar një kërkesë për informacion nëse nga Ministria e Kulturës, në periudhën e festave të fundvitit, ishte kërkuar vizë hyrje nga persona që zhvillojnë aktivitet në fushën e artit në Shqipëri. Po kështu, nëse përgjigja do të ishte pozitive, autoritetit të huaj i është kërkuar të na vinte në dispozicion listën emërore të grupit.

*Në përgjigjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që mban datën 26.5.2011, e cila është administruar në fashikullin penal, konfirmohet më së pari fakti i marrjes së shkresës tonë me nr. *** prot., datë 28.3.2011. Gjithashtu, agjenti special i kësaj zyre shpjegon se informacioni i referuar nga ana jonë është shqyrtuar prej tyre dhe i është kaluar më pas seksionit përkatës në Ambasadë. Agjenti special bën me dije se ata do të vazhdojnë të monitorojnë informacionin e referuar nga ana jonë dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme.*

Në fund, duke bërë të qartë se ligji i vendit u ndalon të zbulojnë informacione që lidhen me aplikantët për viza, agjenti special siguron se nëse do të ketë një shkelje të ligjit shqiptar ata do të na kontaktonin menjëherë.

Me këto përgjigje të ardhura nga Ministria e Kulturës dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u bë e qartë në atë kohë se nuk ekzistonte asnjë provë apo edhe indicie për të çuar te dyshimi i arsyeshëm se persona të caktuar, të përmendur nga shtetasi A.K, po kryenin veprimtari të kundërligjshme, që lidhej me ndonjë ndihmë konkrete për kalim të paligjshëm të kufijve apo falsifikim të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave.

Pushimi i procedimit penal, i cili i është dërguar rregullisht për njoftim kallëzuesit A. K, është bërë sipas germës 'b' të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale (ligji i kohës), i cili parashikonte se: 'Në çdo fazë të procedimit, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur :... b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale''.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e procedimit penal nr. ***, nga verifikimi i së cilës rezulton se:

- Në datën 27.6.2011 shtetasit A.K i është njoftuar vendimi datë 15.6.2011 për pushimin e procedimit penal. Ky vendim nuk rezulton të jetë ankimuar nga kallëzuesi.
- Subjekti, në datën 28.3.2011, i ka dërguar shkresën nr. *** prot. Ministrisë së Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, duke kërkuar informacion nëse në periudhën e festave të fundvitit 2010 është kërkuar vizë hyrjeje pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ndonjë grup punonjësish apo personash të tjerë, që zhvillojnë aktivitet në fushën e artit.
- Subjekti, në datën 28.3.2011, me shkresën nr. *** prot., i është drejtuar Zyrës Rajonale të Sigurimit të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara duke i kërkuar të njëjtin informacion si Ministrisë së Kulturës.
- Në datën 22.12.2010 është pyetur shtetasi A.K, si person që tregon rrethanat e hetimit, që ka deklaruar se *ka pasur komunikim me shtetasin E.Sh në datën 16.12.2010, i cili i kishte kërkuar paratë dhe se ai i kishte kthyer përgjigje se nuk i ka të gjitha lekët. Në përfundim e kishin lënë që shtetasi A.K t'i kthente përgjigje dhe që prej asaj dite nuk kishin komunikuar më bashkë. Në të njëjtën datë dhe në datën 21.12.2010 ka folur edhe me shtetasin J.P, i cili në përfundim të bisedës i kishte thënë të bënte çfarë të donte.*

Në përfundim në lidhje me këtë denoncim, Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe fashikullin penal të procedimit penal nr. ***, vlerëson se, përveç mungesës së vendimeve për zgjatjen e hetimit, nuk konstatohen shkelje procedurale që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe për t'u vlerësuar më tej si mangësi profesionale.

2. Denoncim i shtetasës Sh.K³⁸

Denoncuesja ankohet lidhur me vendimin për “mosfillimin e hetimeve të kallëzimit penal nr. ***, viti 2016” të subjektit të rivlerësimit për çështjen penale të regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga kjo shtetase në ngarkim të avokatit M. I.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja rezulton se në datën 14.6.2016 ka ndodhur një konflikt fizik mes denoncueses dhe shtetasit M. I, me profesion avokat. Pas konfliktit, shtetasja Sh.K është dërguar për trajtim mjekësor në spital, në repartin e traumës. Ajo ka njoftuar forcat e policisë dhe ka dhënë deklaratimet e para mbi ngjarjen. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer verifikimet përkatëse, ka konkluduar se faktet e referuara nuk parashikohen nga ligji si vepër penale. Në veprimet e para hetimore është administruar aktekspertimi mjeko-ligjor, i cili ka konkluduar se dëmtimet që ka pësuar shtetasja Sh. K konsistojnë në dëmtime që hyjnë në kategorinë e dëmtimeve, të cilat sjellin si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme në punë në masën deri në 9 ditë pushim, pra në kategorinë “rrahje”. Bazuar në provat e administruara, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se në dëm të shtetasës Sh.K mund të jetë konsumuar vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 4.4.2019.

90 i Kodit Penal. Në referim të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, kallëzuesi, si person i dëmtuar nga vepra penale, ka të drejtë të paraqesë në gjykatë dhe njëkohësisht të marrë pjesë në gjykim, me qëllim vërtetimin e akuzës dhe shpërblimin e dëmit. Subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me këtë material kallëzues.

Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesja Sh.K dhe mbi bazën e ankimit të saj Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr. *** regjistri themeltar, datë 13.10.2016, shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendimi i mosfillimit duhet të shfuqizohet, pasi nuk janë pyetur dëshmitarë okularë, si dhe kallëzuesja ka shpjeguar se ka pasur edhe kërcënime për jetën. Gjykata çmon se, në varësi të rezultateve të detyrave të lëna për pyetjen e dëshmitarëve, prokurori mund të vlerësojë nëse ka vend për veprime të tjera hetimore.

Në përfundim, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim, të shpjegojë dhe të depozitojë dosjen e plotë të kësaj çështjeje, dokumentacionin përkatës lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur nga ana e tij për plotësimin e detyrave të lëna nga gjykata.

Në lidhje me këtë denoncim, subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit,³⁹ ka sqaruar: *“Referuar urdhërimit të Gjykatës së Apelit Tiranë është regjistruar procedimi penal që bën fjalë për veprën penale ‘kanosja’, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Kjo, në kushtet kur asnjë vepër tjetër, që lidhet me dëmtimet e pësuar nga shtetasja Sh.K, nuk mund të regjistrohej për t’u hetuar në kuadër të ndonjë procedimi penal, për aq kohë sa mbetej i provuar fakti që këto dëmtime ishin kategorizuar si ‘rrahje’.*

Në vijim, në kuadër të këtij procedimi dhe në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit, janë marrë deklaramë nga shtetasja Sh.K, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale.

E pyetur nëse është kanosur nga shtetasi M.I, viktimë, në ndryshim nga deklaramet e saj të datës 14.6.2016, pohon se është kërcënuar në telefon me fjalët: ‘... mos më dil përpara se do të zhduk’. Gjithashtu, sipas viktimës, shtetasi M.I i ka thënë edhe fjalë të tjera kërcënuese në telefon, të cilat nuk i mban mend konkretisht. E pyetur nëse shtetasi M.I ka kryer ndonjë veprim konkret për të materializuar kanosjen ndaj saj, viktimë përgjigjet negativisht. E pyetur në lidhje me takime të tjera pas ditës së ngjarjes, viktimë përgjigjet se nuk ka pasur. Sipas viktimës, shtetasi M.I e ka goditur me grushte dhe shkelma, si dhe e ka kapur nga flokët, duke e tërhequr zvarrë. Shprehjet që ka përdorur shtetasi i kallëzuar, gjatë konfliktit fizik, referuar shpjegimeve aktuale të kallëzueses, kanë qenë: ‘... ik zhduku, kam për të të mbytur, pse ma bëre atë ...’.

Në lidhje me rrethanat e ngjarjes, referuar detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit, është pyetur dhe shtetasi M.I, në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Ky shtetas, ndër të tjera, shpjegon se ditën e ngjarjes shtetasja Sh.K ka ardhur në banesën e tij dhe ka tentuar të hyjë brenda. Duke qenë se në banesë në ato momente nuk kishte persona të tjera, deklaruesi shpjegon se nuk e ka lejuar duke mbyllur derën forcërisht.

Në lidhje me kanosjen e pretenduar, deklaruesi shprehet se në asnjë moment nuk ka kërcënuar ndonjë person, pasi problemet e tij është mësuar t’i zgjidhë në rrugë ligjore. Në lidhje me

³⁹ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

rastin, deklaruesi shton se që në momentet e para pas ngjarjes ka qenë ai që është drejtuar me kallëzim penal ndaj shtetases Sh.K.

Për sa më lart, pas kryerjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit dhe pas analizës së plotë të rrethanave të ngjarjes dhe provave të administruara në fashikullin hetimor, është arritur në përfundimin se çështja penale nr. ***, e vitit 2019, duhet të pushohej.

Duke marrë të mirëqena deklaratimet e shtetases Sh.K, dhënë në datën 8.1.2019, të cilat ndryshojnë nga ato të datës 14.6.2016, përsëri kam konstatuar se në kuptim të dispozitës penale, neni 84 i ligjit material, e cila parashikon se 'Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me ...', mungojnë tërësisht elementet përmbushës të figurës së veprës penale.

Në vendim kam arsyetuar se karakteristikë thelbësore për këtë veprë është 'ana objektive e saj'. Nga ana objektive kjo veprë penale kryhet me veprime të kundërligjshme dhe që e bëjnë kanosjen ndaj personit të jetë 'serioze'. Pra, këto veprime, duhet të jenë të tilla në mënyrë që t'i krijojnë personit të kanosur bindjen se personi që e kanos atë i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet për ta vrarë apo për ta plagosur rëndë atë.

Që kanosja ndaj një personi të jetë 'serioze', një rol të rëndësishëm kanë 'mjetet' e përdorura nga personi që e kanos, 'vendi' ku realizohet kanosja, përsëritja disa herë me radhë e një sërë veprimesh që personit të kanosur t'i krijohet bindja se personi që e kanos atë i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet për ta vrarë atë apo për ta plagosur rëndë. Në rastin objekt hetimi nuk rezultoi asnjë e dhënë konkrete se diçka e tillë kishte ndodhur.

Për të gjitha arsyet sa më lart, fakti për të cilin u regjistrua në atë kohë ky procedim (sipas urdhërimeve të Gjykatës së Apelit) nuk parashikohej nga ligji material si veprë penale dhe unë, në cilësinë e prokurorit të çështjes, e pushova atë bazuar në nenin 328/1, germa 'b', të Kodit të Procedurës Penale.

Me marrjen njoftim të vendimit të pushimit të çështjes penale, shtetasja Sh.K përsëri i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila nga ana e saj, me vendimin nr. ***akti, datë 7.11.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzueses duke lënë në fuqi vendimin e pushimit. Kallëzuesja ka vijuar në ushtrimin e të drejtës së saj të ankimit, duke e çuar çështjen në Gjykatën e Apelit, e cila me vendimin nr. ***, datë 16.2.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Veç sa më lart, shtetasja Sh.K i është drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë me ankesën nr. *** prot., datë 25.2.2020, duke paraqitur pretendime për veprimtarinë time si prokuror, duke parashtruar dhe ngjarjen sipas këndvështrimit të saj. Kjo ankesë i është përcjellë për shqyrtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pas shqyrtimit të ankesës, ILD-ja ka marrë vendimin me nr. *** prot., datë 25.7.2022, për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja Sh.K, për gjithë arsyet që u parashtruan më sipër".

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e procedimit penal nr. ***, nga verifikimi i së cilës rezulton se:

- Në datën 8.1.2019 është pyetur shtetasja Sh.K në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale.
- Në datën 14.1.2019 është pyetur shtetasi M.I në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale.

- Në datën 21.1.2019 subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal duke argumentuar se pas kryerjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit dhe pas analizës së plotë të rrethanave të ngjarjes dhe provave të administruara arrihet në përfundimin se çështja penale nr. *** duhet të pushohet.
- Në datën 31.1.2019, me shkresën nr. *** prot., subjekti i ka dërguar kallëzueses njoftimin e vendimit të pushimit.
- Vendimi i pushimit, bazuar në vendimin nr. ***, datë 16.2.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton të jetë ankimuar nga kallëzuesja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 17.11.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kallëzueses. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, e cila ka argumentuar se vendimi i prokurorisë është i drejtë dhe nuk ka shkaqe për prishjen apo shfuqizimin e tij. Organi i Prokurorisë ka hetuar dhe ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt akuze dhe mbi bazën e tyre ka arritur në konkluzion se duhet vendosur pushimi i procedimit.
- Denoncuesja ka bërë ankim edhe në ILD, e cila ka vendosur arkivimin e ankesës në datën 25.7.2022.

Në përfundim, në lidhje me këtë denoncim, Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe fashikullin penal të procedimit penal nr. ***, vlerëson se nuk konstatohen shkelje procedurale që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit apo për t'u vlerësuar si mangësi profesionale.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

104. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

105. Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. subjekti arrin nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar

në nenit 4, pikës 2, nenit 58, pikës 1, germës “a”, si dhe nenit 59, pikës 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ols Dado, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 3.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Anëtar

Genta TAFA (BUNGO)

Relatore

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha